



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 372/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Jollxhi Shala kryetar i subjektit politik ‘Kosovski Nevi Romani Partia’ me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Jollxhi Shala kryetar i subjektit politik ‘Kosovski Nevi Romani Partia’-KNRP, me seli në Prizren.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 09:25 , ka pranuar një ankesë nga Jollxhi Shala kryetar i subjektit politik ‘Kosovski Nevi Romani Partia’-KNRP, me seli në Prizren, në të cilën pretendon se pas rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, kanë vërejtur parregullësi në komunat: Gjakovë, Gjilan, Rahovec, Fushë Kosovë, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Ferizaj, Gllogovc, Viti, Podujevë, dhe si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Përputhjes së Rezultateve-FPR për këto komuna.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës, pretendon se ka pas parregullësi në Komunat Gjakovë, Gjilan, Rahovec, Fushë Kosovë, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Ferizaj, Gllogovc, Viti, Podujevë, mirëpo ankuesi nuk e ka specifikuar në ankesën e tij se cilat janë parregullësit që pretendon se i janë bërë me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar dhe në cilat vendvotime kanë ndodhur këto parregullësi. Dëshmit e orfruar nga ankuesi janë përshkrim i vendvotimeve ku pretendohet se kanë vota te mundshme por në asnjë rast nuk ka ofruar dëshmi që në vendvotimin e

caktuar i janë bërë parregullësi, dhe po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Prandaj, paneli vlerëson se pretendimet e ankusit janë të përgjithsuara dhe mungesë të provave, dëshmime konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzon.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.372/2017 më datën 02.07.2017

**Kryesuesi i Panelit**

**Adnan Konushevci**



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*